

UDHËZIM
Nr. 1, datë 9.1.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.23, DATË 9.12.2014 “PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2013, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10 383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ministri i Financave,

UDHËZON:

1.Në udhëzimin nr. 23, datë 9.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, bëhet ky ndryshim:

“Në kreun 8 “Rimbursimi i kontributeve”, në pikën 8.1 germa f), shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin e tij në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani